

Abstrakt

Martesa është institucion i rëndësishëm juridik dhe shoqëror. Ajo është bazë e familjes dhe ka funksione të shumta shoqërore dhe për këtë arsye mbrohet nga shteti dhe shoqëria. Për nga aspekti juridik, martesa cilësohet si bashkëjetesë e vazhdueshme e burrit dhe gruas, e rregulluar me norma juridike.

Ashtu siç ekziston e drejta e lidhjes së martesës, ekziston edhe e drejta për zgjidhjen e saj. Sipas legjilacionit në Kosovë zgjidhja e martesës është e rregulluar me Ligjin për Familjen, ndërsa në Shqipëri është e rregulluar me Kodin e Familjes së Shqipërisë.

Gjatë trajtimit të këtij punimi mund të vërehet se martesa si institucion, e poashtu edhe zgjidhja e saj ka evoluar në periudha të ndryshme kohore. Andaj, gjatë analizimit dhe krahasimit të institutit të zgjidhjes së martesës mund të vërehet se si ka evoluar zgjidhja e martesës që nga e drejta romake. Qëllimi kryesor i trajtimit të kësaj teme është zgjidhja martesës në periudha të ndryshme kohore të së drejtës romake, duke pasur parasysh se numër i madh i instituteve të së drejtës familjare, posaqërisht martesa, e ka bazën e rregullimit të hershëm juridik në të drejtën romake dhe poashtu të bëhet krahasimi i rregullimit normative sot, sipas legjilacionit në Kosovë dhe Shqipëri.

Fjalet kyçe: Martesë, zgjidhje e martesës, shkurorëzim, procedura e zgjidhjes së martesës së vlefshme, pasojat e zgjidhjes së martesës

Abstract

Marriage is an important legal and social institution. It is the basic of the family and has many social functions and is therefore protected by the state and society. From a legal point of view, marriage is considered as a continuous coexistence of man and woman, regulated by norms.

Just as there is the right to enter into marriage, there is also the right to dissolve it. According to the legislation in Kosovo, the dissolution of marriage is regulated by the Family Law, while in Albania it is regulated by Albanian Family Code.

During the treatment of this paper it can be noticed that marriage as an institution, as well as its dissolution has evolved in different periods time. Therefore, during the analysis and comparison of the institution dissolution can be observed how the dissolution of marriage has evolved from Roman law, given that a large number of institutes of family law, especially marriage, have the basis of early regulation in Roman law and also to compare the normative regulation today, according to the legislation in Kosovo and Albania.

Keywords: Marriage, marriage dissolution, divorce, procedure of dissolution, consequences of marriage dissolution.